

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË ELBASAN

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Elbasan**, me objekt: “*Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, aktivitetin ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve të qëndrueshme, dhënien me qira të objekteve, funksionimi i policisë bashkiake, prokurimet me fonde publike, funksionimin dhe veprimtarinë e INUV, taksat dhe tarifave vendore, etj.*”, lloji i auditimit: “*Auditim Financiar*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 78, datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 307/7, datë 30.06.2014, i ka rekomanduar z. Qazim Sejдини, Kryetar i Bashkisë Elbasan, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1-Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të mos zbardhen vendime të miratuara nga ish-KRRT-ja, që i përkasin periudhës 2009-2010-2011, në zbatim të VKM nr. 502, datë 13.7.2011 “*Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit*” të ndryshuar, me VKM nr. 139, datë 22.02.2012, me pikën 2/1, trajtuar në pikën 8.2.

Vazhdimisht

2-Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, dokumentacioni i lejeve të përdorimit të jetë i plotë, në zbatim të kreu II, neni 9 dhe neni 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, të ndryshuar dhe UKM nr. 1, datë 16.6.2011, Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërtimeve*”.

Vazhdimisht

3-Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të mbahet Regjistri i Planifikimit të Territorit, në zbatim të Kreut V, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “*Për planifikimi e territorit*”, të ndryshuar dhe VKM nr. 460, datë 16.6.2010 “*Për organizimin dhe funksionimin e regjistrit të planifikimit të territorit*”.

Brenda datës 30 gusht 2014

4-Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të respektohet distanca nga kufiri maksimal i pronës, Intensiteti i sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit me sipërfaqen e parcelës ndërtimore dhe koeficientin e shfrytëzimit të tokës, në zbatim të nenit 40, 43 dhe 44, të VKM nr. 502, datë 13.7.2011 “*Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit*”, të ndryshuar.

Vazhdimisht

5-Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, gjatë miratimit të Lejeve të Zhvillimit, dokumentacioni i pronësisë dhe Kontrata e Sipërmarrjes të jenë me sipërfaqe të njëjtë, si dhe para miratimit të lejes të bëhet bashkimi i parcelave që do të zhvillohen, në zbatim të nenit 24, të VKM nr. 502, datë 13.7.2011 “*Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit*”, të ndryshuar.

Vazhdimisht

6- Nga Sektori i Menaxhimit të Pronave, të merren masa dhe të kryhet inventarizimi fizik i aseteve dhe pasqyrimi elektronik i këtij inventari, pasuritë e transferuara, të përfshihen në inventarin kontabël pasuror. Për çdo pasuri të paluajtshme të hartohen hartat si: plan rievimi apo planimetritë duke përcaktuar të dhënat përkatëse si zonën kadastrale, llojin e pasurisë, vendndodhjen, sipërfaqen kufizimet, statusi juridik i disponimit vendor (*në pronësi apo në posedim*) si dhe 183 pasuri të dërgohen për regjistrim në ZVRPP Elbasan, në zbatim me nenin 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “*Për kontabilitetin dhe për pasqyrat financiare*”,

ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me kapitullin e III të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Brenda datës 30 gusht 2014

7-Nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik, të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i gjobave në shumën 27 953 545 lekë, në zbatim me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar dhe pika 3 nenin 83, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

Brenda datës 30 dhjetor 2014

8-Nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik, të zbatohen vendimet për prishje të objekteve pa leje, në zbatim me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar dhe pikën 3 nenin 83, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

Brenda datës 30 gusht 2014

9-Nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik, të merren masa, që për 47 subjekte që kanë ndërtuar pa leje të bëhet kallëzim penal, në zbatim të nenit 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar dhe pikën 3 nenin 83, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

Brenda datës 30 gusht 2014

10-Nga Bashkia Elbasan të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për rigjykimin e çështjes, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr. 790, datë 7.04.2011 në disfavor të Bashkisë Elbasan, i cili është pranuar nga Bashkia Elbasan dhe nuk është kërkuar shfuqizimi i këtij vendimi pranë Gjykatës së Apelit Durrës, në kundërshtim me UMF nr. 1, datë 21.01.2010 “Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2010” pika 125 të paragrafit 4.4, Vendimet Gjyqësore, ku shkruhet “Për vendimet gjyqësore do të veprohet në përputhje me vendimin nr. 335, datë 02.06.1998 “Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit”, si dhe akte të tjera nënligjore në këtë drejtim për shumën prej 80,030,574 lekë.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

-Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Bashkia Elbasan të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat në vlerën **30,847,525** lekë si më poshtë:

1-Për subjektin “**V...I...**” sh.p.k. në vlerën **4,754,880** lekë, pasi për periudhën 02.4.2012 deri më 31.2012 ka transportuar dhe manipuluar 5.2 ton mbetje urbane më pak në ditë (80-74.8) duke përfutur padrejtësisht 2,021,760 lekë dhe për periudhën e vitit 2013 ka transportuar dhe manipuluar 5.2 ton mbetje urbane më pak në ditë (80-74.8) duke përfutur padrejtësisht 2,733,120 lekë, në kundërshtim me pikat 8 a, b të nenit 3 dhe nenin 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III, pika 35 b dhe 36; pikën 9 dhe 26 43 të nenit 4, pikën 3 të nenit 12, pikën 2 të nenit 16 dhe pikën 5 të nenit 23, të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me nenet 11, 11.1, 11.2 dhe 20 të kontratës së lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë “**V...I...**” sh.p.k. për “Kryerjen e shërbimit të pastrimit të qytetit Elbasan”, duke sjellë një dëm ekonomik prej 4,754,880 lekë e cila duhet të arkëtohet nga Shoqërisë “**V...**” sh.p.k.

Menjëherë

2-Për subjektin “**V...H...**” sh.p.k. në vlerën **21,398,637** lekë, dëme për vonesa në zbatim të kontratës me objekt “Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugës “*Krasta e Madhe*” (*Faza e parë*)”. Nga Bashkia me shkresën nr. 1006, datë 26.3.2014 është njoftuar operatori “**V... H...**” sh.p.k. se “.....vazhdoni të jeni me vonesë për dorëzimin e objektit në këto kushte ju njoftojmë se për c do ditë vonesë do të kërkojmë dëmet e likuidueshme...” dhe deri në datën 31.03.2014 nuk janë paraqitur situacionet e tjera të punimeve të kryera dhe të përfunduara.

Sipas kontratës nenit 33/2: “Me përjashtim kur autoriteti kontraktor është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda afatit së dorëzimit të plotë të specifikuar në kontratë” dhe nenit 33/5; “ nëse autoriteti kontraktor është dakord me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës së nënshkruar nga autoriteti kontraktor”. Sipas nenit 34 të kontratës “Dëmet e likuidueshme për vonesat në mbarimin e punimeve” do të llogariten në tarifën e mëposhtme ditore: b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”. Për llogaritjet bëhen për diferencën e punimeve të pa kryera vleftën e tre situacione punimesh të cilat duhet ti zbriten shumës prej 67,311,225 lekë dhe pjesa e mbetur është 28,684,371 lekë. ($0.002 \times 28,684,371 \text{ lekë} = 57,369 \times 373 \text{ ditë} = 21,398,637 \text{ lekë}$). Detyrimi i gjobës për tejkalim të afateve të realizimit të kontratës nga operatori “Vëllezërit Hysa” sh.p.k është 21,398,637 lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet.

Menjëherë

3-Për D.Ç. në shumën **301,448** lekë, **K.Xh. 301,448** lekë, **Sh.K. 301,447** lekë pasi si anëtarë të KVO në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes fizike të objekteve në administrim të Bashkisë Elbasan dhe institucioneve në varësi ta saj”, bashkimi i operatorëve “H...” sh.p.k. & “M... Security” sh.p.k me ofertën 11,588,715 lekë pa t.v.sh. është skualifikuar me arsyetimin sipas procesverbalit të datës 5.3.2012 se: “Në datën 8.3.2012 operatori ekonomik “M...” sh.pk., depozitoi pranë zyrës së arkivit të bashkisë Elbasan, shkresën me nr. 15 prot. datë 7.3.2012 nëpërmjet së cilës i drejtohet autoritetit kontraktor Bashkia Elbasan, duke kërkuar tërheqjen nga pjesëmarrja në këtë prokurim. Komisioni i vlerësimit të ofertave, pasi shqyrtoi këtë kërkesë, vendosi ta pranojë atë dhe për rrjedhojë të skualifikojë bashkimin e operatorëve “H...” sh.p.k & “M... S...” sh.p.k”.

Kur “H...” sh.p.k. & “M... Security” sh.p.k. me ofertën 11,588,715 lekë pa t.v.sh. duhej të shpallej fitues nga KVO dhe mbas kërkesës së datës 8.3.2012 nga njëri prej bashkimit të operatorëve “për tërheqje” KVO duhej të kërkonte arkëtimin e sigurimit të ofertës prej 249,995 lekë dhe të anulonte procedurën e tenderit sipas ligjit nr. 9463, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” neni 58, pika 5. KVO ka shpallur fitues “K...” sh.p.k. & “B...-G” sh.p.k me ofertën 12,384,000 lekë pa t.v.sh. dhe diferenca me “H...” sh.p.k. & “M... Security” sh.p.k me ofertën 11,588,715 lekë pa t.v.sh. është 795,285 lekë pa t.v.sh duke zbritur sigurimin e ofertës prej 249,995 lekë = $545,290 \text{ lekë} \times 20\% = 109,058 = 654,348 \text{ lekë}$ me t.v.sh. Në total dëmi i shkaktuar është 904,343 lekë ($249,995 + 654,348 = 904,343 \text{ lekë}$) të cilat duhet të arkëtohen nga anëtarët KVO.

Menjëherë

4-Për subjektin “B...” sh.p.k. në vlerën **458,102** lekë për sa rezulton nga diferenca e sasive të bërë hyrje në litra dhe të likuiduara në kg:

për vitin 2012:

1-“Vaj ushqimor” 600 litra $\times 0.918 = 550 \text{ kg}$. ($600 \text{ kg} - 550 \text{ kg} = 50 \text{ kg} \times 223.8 = 11,190 \text{ lekë}$). Sipas llogaritjeve të mësipërme subjekti ka përfituar më tepër 11,190 lekë të cilat përbëjnë dëm ekonomik dhe duhet ti arkëtojë.

2-“Vaj ulliri” 8,967 litra $\times 0.915 = 8,204 \text{ kg}$. ($8,967 \text{ kg} - 8,204 \text{ kg} = 763 \text{ kg} \times 559.2 = 426,670 \text{ lekë}$). Sipas llogaritjeve të mësipërme subjekti ka përfituar më tepër 426,670 lekë të cilat përbëjnë dëm ekonomik dhe duhet ti arkëtojë.

për vitin 2013:

1-Duhej bërë hyrje sasia prej 918 kg ($1000 \text{ litra} \times 0.918$) me vlerë 225,828 lekë ($918 \text{ kg} \times 246 \text{ lek/kg}$), është bërë hyrje më tepër në vlerën prej 20,172 lekë që përbën dëm ekonomik.

1-Duhej bërë hyrje sasia prej 18.3 kg ($20 \text{ litra} \times 0.915$) me vlerë 757.62 lekë ($18.3 \text{ kg} \times 41.4 \text{ lek/kg}$), është bërë hyrje më tepër në vlerën prej 70 lekë, që përbën dëm ekonomik.

Menjëherë

5-Për subjektin “B...” sh.a. në vlerën **62,435** lekë pasi nga llogaritja e furnizimit të likuiduar në zbatim të kontratës datë 30.12.2011 me objekt “Blerje karburanti”, me operatorin rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar buletin të APP datën 19 dhjetor 2011 si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar prej 1,795,633 lekë për sasinë

e gazoilit D1 prej 9,759 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 177.6 lekë/litri e cila është 1,733,198 lekë duke sjellë një pagesë tepër prej 62,435 lekë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet nga subjekti “B...” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, pika 2/c dhe datë 31.12.2011 neni 4. *“Nëse çmimi, gjatë kohës së zbatimit të kontratës..... ndryshon dukshëm, me kërkesë me shkrim të palëve, pasqyron, në faturat periodike të shitjes, çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD.”*

Menjëherë

6-Subjekti “B...” sh.a. në vlerën **152,334** lekë pasi nga llogaritja e furnizimit të likuiduar në zbatim të kontratës datë 12.3.2011 me objekt “*Blerje karburanti*”, me operatorin rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar buletinit të APP datën 25 janar 2012 si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar prej 7,327,297 lekë për sasinë e gazoilit D1 prej 39,358 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 182.3 lekë/litri e cila është 7,174,963 lekë duke sjellë një pagesë tepër prej 152,334 lekë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet nga subjekti “B...” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, pika 2/c dhe datë 12.3.2011 neni 4. *“Nëse çmimi, gjatë kohës së zbatimit të kontratës..... ndryshon dukshëm, me kërkesë me shkrim të palëve, pasqyron, në faturat periodike të shitjes, çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD.”*

Menjëherë

7-Subjekti “B...” sh.a. në vlerën **13,170** lekë pasi nga llogaritja e furnizimit të likuiduar në zbatim të kontratës datë 3.01.2013 me objekt “*Blerje karburanti*”, me operatorin rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar buletinit të APP datën 27 dhjetor 2012 si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar prej 1,461,098 lekë për sasinë e gazoilit D1 prej 8,012 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 180.72 lekë/litri e cila është 1,447,928 lekë duke sjellë një pagesë tepër prej **13,170** lekë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet nga subjekti “B...” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, pika 2/c dhe datë 3.01.2013 neni 4. *“Nëse çmimi, gjatë kohës së zbatimit të kontratës..... ndryshon dukshëm, me kërkesë me shkrim të palëve, pasqyron, në faturat periodike të shitjes, çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD.”*

Menjëherë

8-Subjekti “M...” sh.a. në vlerën **42,921** lekë pasi nga llogaritja e furnizimit të likuiduar në zbatim të kontratës datë 9.4.2013 me objekt “*Blerje karburanti*”, me operatorin rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar buletinit të APP datën 9 prill 2013 si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar prej 3,679,320 lekë për sasinë e gazoilit D1 prej 20,590 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 176.61 lekë/litri e cila është 3,636,399 lekë duke sjellë një pagesë tepër prej 42,921 lekë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet nga subjekti “M...” sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, pika 2/c dhe datë 3.01.2013 neni 4. *“Nëse çmimi, gjatë kohës së zbatimit të kontratës..... ndryshon dukshëm, me kërkesë me shkrim të palëve, pasqyron, në faturat periodike të shitjes, çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD.”*

Menjëherë

9-Subjekti “B...N” sh.p.k. në vlerën **748,020** lekë pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit për “*Sistemim Asfaltim i rrugës “Kasem Sejdiu” dhe i rrugës “Koço Brisku”, Lagja “5 Maji”*”, rezultojnë diferenca në volume pune të pakryera në shumën 748,020 lekë me t.v.sh. duke shkaktuar dëm ekonomik të cilat duhet të arkëtohen nga operatori sipërmarrës “B... N” sh.p.k.

Menjëherë

10-Subjekti “B...N” sh.p.k. në shumën **1,528,275** lekë pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit për “*Rikonstruksion Bulevardi “Qemal Stafa”, segmenti III-të nga kryqëzimi me lulishten “K. Naska”, deri në rrugën “Kasem Sejdiu”*”, Bashkia Elbasan rezultojnë diferenca në volume pune të pakryera

në shumën 1,528,275 lekë me t.v.sh. duke shkaktuar dëm ekonomik të cilat duhet të arkëtohen nga operatori sipërmarrës “B...N” sh.p.k.

Menjëherë

11-Subjektin “A...” sh.p.k. në vlerën **352,923** lekë pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit për Sistemim Asfaltim i sheshit para pallatit nr. 18, rruga “Azmi Stringa” + sheshet e pallateve 42,42/2,42/3,42,5, Lagja “Luigj Gurakuqi”, Bashkia Elbasan rezultojnë diferenca në volume pune të pakryera në shumën 352,923 lekë me t.v.sh. duke shkaktuar dëm ekonomik të cilat duhet të arkëtohen nga operatori sipërmarrës “A...” sh.p.k.

Menjëherë

12-Subjektin ndërtues “K...” sh.p.k në shumën **196.025** lekë, për sa llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet.

Menjëherë

13-Fondacioni “S...” në shumën **199,026** lekë pasi nuk janë llogaritur kamatë vonesa për 5 muaj në kundërshtim me kapitullin e III të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

14-T.D. në shumën **36,434** lekë pasi nuk është arkëtuar qira objekti për muajin mars, prill, maj viti 2013, në shumën 33,600 lekë dhe për pagesat e kryera jashtë afatit të kontratës, nuk janë llogaritur dhe arkëtuar kamatë vonesa në shumën 2,834 lekë të cilat përbëjnë dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohen.

Menjëherë

A. MASA DISIPLINORE

a-Mbështetur në kreu IV, neni 11, germa “e” dhe “ç” dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kontratës individuale të punës, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë, Elbasan fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, për punonjësit si më poshtë:

“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për punonjësit e mëposhtëm:

1- A.L. me detyrë supervizor i shërbimit publik të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave,
2- M.L. me detyrë supervizor i shërbimit publik të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave.
Për sa përfituar subjekti “Viktoria Invest” sh.p.k. në vlerën 4,754,880 lekë, pasi për periudhën 02.4.2012 deri më 31.2012 ka transportuar dhe manipuluar 5.2 ton mbetje urbane më pak në ditë (80-74.8) duke përfituar padrejtësisht 2,021,760 lekë dhe për periudhën e vitit 2013 ka transportuar dhe manipuluar 5.2 ton mbetje urbane më pak në ditë (80-74.8) duke përfituar padrejtësisht 2,733,120 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikat 8 a, b të nenit 3 dhe nenin 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III, pika 35 b dhe 36; pikën 9 dhe 26 të nenit 4, pikën 3 të nenit 12, pikën 2 të nenit 16 dhe pikën 5 të nenit 23, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me nenet 11, 11.1, 11.2 dhe 20 të kontratës së lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë “Viktoria Invest” sh.p.k. për “Kryerjen e shërbimit të pastrimit të qytetit Elbasan”, duke sjellë një dëm ekonomik prej 4,754,880 lekë e cila duhet të arkëtohet nga Shoqërisë “Viktoria Invest” sh.p.k.

3-L.K. me detyrë Kryeinspektor i Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik nga data 01.11.2012.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e nenit 5 dhe 15, shkronja “a”, “c”, “e”, nenin 12, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektoratin ndërtimor e urbanistik” pika 1, 2, 3, 4, 7 e 8 të VKM nr. 862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor” dhe pikën 3 nenin 83, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

b. Në zbatim të nenit 72 pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, pika 3, mbështetur në nenin 58 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil”, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Elbasan, në cilësinë e autoritetit kontraktor, që për shkeljet e konstatuara në zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike, të japë masën disiplinore:

“Vërejtje” sipas nenit 58, germa “a”, për:

4.K.Xh. anëtar i KVO,

5.Sh.K. anëtar i KVO,

pasi si anëtarë të KVO në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes fizike të objekteve në administrim të Bashkisë Elbasan dhe institucioneve në varësi ta saj”, bashkimi i operatorëve “H...” sh.p.k. & “M...Security” sh.p.k me ofertën 11,588,715 lekë pa t.v.sh. është skualifikuar me arsyetimin sipas procesverbalit të datës 5.3.2012 se: “Në datën 8.3.2012 operatori ekonomik “M...” sh.pk., depozitoi pranë zyrës së arkivit të bashkisë Elbasan, shkresën me nr. 15 prot. Datë 7.3.2012 nëpërmjet së cilës i drejtohet autoritetit kontraktor Bashkia Elbasan, duke kërkuar tërheqjen nga pjesëmarrja në këtë prokurim. Komisioni i vlerësimit të ofertave, pasi shqyrtoi këtë kërkesë, vendosi ta pranojë atë dhe për rrjedhojë të skualifikojë bashkimin e operatorëve “H...” sh.p.k & “M...Security” sh.p.k”.

Kur “H...” sh.p.k. & “M...Security” sh.p.k. me ofertën 11,588,715 lekë pa t.v.sh. duhej të shpallej fitues nga KVO dhe mbas kërkesës së datës 8.3.2012 nga njëri prej bashkimit të operatorëve “për tërheqje” KVO duhej të kërkonte arkëtimin e sigurimit të ofertës prej 249,995 lekë dhe të anulonte procedurën e tenderit sipas ligjit nr. 9463, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” neni 58, pika 5. KVO ka shpallur fitues “K...” sh.p.k. & “B...” sh.p.k me ofertën 12,384,000 lekë pa t.v.sh. dhe diferenca me “H...” sh.p.k. & “M...Security” sh.p.k me ofertën 11,588,715 lekë pa t.v.sh. është 795,285 lekë pa t.v.sh duke zbritur sigurimin e ofertës prej 249,995 lekë = 545,290 lekë x 20% = 109,058 = 654, 348 lekë me t.v.sh. Në total dëmi i shkaktuar është 904,343 lekë (249,995 + 654,348 = 904,343 lekë) të cilat duhet të arkëtohen nga anëtarët KVO.

c-Mbështetur në nenin 58 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, kërkojmë nga Kryetari i Bashkisë, që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje” sipas nenit 58, germa “a”, për:

6- R.H. detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe në cilësinë e Sekretarit të KRRT-së.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e nenit 38, 44, 45, 46 dhe 51, të ligjit nr. 8405, datë 19.09.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, me nenin 9 e 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, Kreun e V “Regjistri i Planifikimit të Territorit”, pikën 1, të nenit 70/3, pikën 1, germa “ç” të nenit 70/13, me pikën 2, të nenit 70/14, pikën 1, të nenit 70/15, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, nenin 24, 40, 43, 44, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM nr. 460, datë 16.06.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e regjistrit të planifikimit të territorit”, pikën 52,66, 85, 118 dhe 120 të VKM nr. 722, datë 19.11.19898 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës” dhe UKM nr. 1, datë 16.06.2011, Për disa ndryshime ne Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërtimeve”.

7- M.A. me detyrë specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e nenit 38, 44, 45, 46 dhe 51, të ligjit nr. 8405, datë 19.09.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, me pikën 52,66, 85, 118 dhe 120 të VKM nr. 722, datë 19.11.19898 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”.

8- B.Zh. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës të regjistrit të Territorit

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e Kreut të V “Regjistri i Planifikimit të Territorit”, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimi e territorit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 460, datë 16.06.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e regjistrit të planifikimit të territorit”.

9- E.K. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Planifikimit të Territorit.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e pikës 1, të nenit 70/3, pikës 1, germa “ç” të nenit 70/13, pikës 2, të nenit 70/14, pikës 1, të nenit 70/15, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe nenin 24, 40, 43, 44, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”.

10- M.V. me detyrë Përgjegjëse në Sektorin e Urbanistikës Ligjore.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e pikës 1, të nenit 70/3, pikës 1, germa “ç” të nenit 70/13, pikës 2, të nenit 70/14, pikës 1, të nenit 70/15, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe nenin 24, 40, 43, 44, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”.

11- F.M. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Pronave.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e nenin 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04. 2004, “Për kontabilitetin dhe për pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, kapitullin e III, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, shkronjën “e” të pikës 1, pika 2 dhe pika 7, të kapitullit II “Për procedurat e dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore” dhe kapitullin e VI “Monitorimi i Kontratave”, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.

12-A.M. me detyrë specialist në Sektorit të Menaxhimit të Pronave.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e nenin 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04. 2004, “Për kontabilitetin dhe për pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, kapitullin e III, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, shkronjën “e” të pikës 1, pika 2 dhe pika 7, të kapitullit II “Për procedurat e dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore” dhe kapitullin e VI “Monitorimi i Kontratave”, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011.

13- H.T. me detyrë juriste nga data 05.11.2012.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e nenit nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar dhe pikën 3 nenin 83, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

Nga Bashkia Elbasan me shkresë nr.911/69, prot, datë 08.08.2014, protokolluar në KLSH me nr.307/8 datë 12.08.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Bexhet Zeqiri, Milo Pano, Qemal Shehu dhe Jonel Nasto, më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT